

EP e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVË QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVË - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data Datum Date
01B	4721
2	08, 11, 2018
Prishtinë / s	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije -  
Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

08/11/2018 Prishtinë, më

489101B Ref. Nr :

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.13 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. dhe shtojcës 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave ( Gazeta zyrtare nr. 1, 18 prill 2011) merr këtë:

V E N D I M

1. Të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit baçellor ( themelor) në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, departamenti i Biologjisë, drejtimi "Biologji aplikative" dhe drejtimi "Biokimiko- Fiziologjik", duhet të vijojnë mësimin me një modul në lëndët klinike.
2. Modulet dhe lëndët e nevojshme për këtë grup të studentëve, i harton Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës.
3. Kandidatët e diplomuar, pas kryerjes së këtyre moduleve do të marrin titullin laborant i lartë mjekësor.

4. Realizimi i moduleve për këtë grup të studentëve duhet të fillojë më së largu në semestrin veror të vitit akademik ( 2018/2019).
5. Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do t'u nënshtrohen procedurave të Licencimit në Ministrinë e Shëndetësisë.
6. Tarifën për shpenzimet e realizimit të këtij studimi, e cakton Rektorati i UP-së, ndërsa MASHT mbulon 50% të këtyre shpenzimeve.
7. Zbatimi i pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi mbikëqyret nga DALSHI i MASHT së bashku me rektoratin e Universitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës.
8. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

#### A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të shënuara më lartë si dhe në bazë të nevojës për rregullimin e çështjes së studentëve të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit baçellor ( themelor) në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, departamenti i Biologjisë, drejtimi "Biologji aplikative" dhe drejtimi "Biokimiko – Fiziologjik", u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi u dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Bordit për regjistrim dhe licencim të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Departamentit të arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë;
- Departamentit të financave në MASHT;
- Zyrës së Sekretarit të MASHT;
- Studentëve sipas kërkesës së tyre;
- Arkivit.

